

Hapet thirrja për bursa për Studentët dhe Staf Akademik për mësimdhënie në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin Camerino, Itali për semestrin e I-rë të vitit akademik 2017-2018

Në kuadër të Programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin akademik për mësimdhënie të Universitetit të Tiranës në Universitetin Camerino, Itali për semestrin e I-rë të vitit akademik 2017-2018.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;
- Mësimdhënie për stafin akademik;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;

Kohëzagjatja e bursave:

- Bachelor (6 muaj);
- Master (6 muaj);
- 14 ditë duke përfshirë dhe 2 ditët e udhëtimit vetëm për stafin akademik;

Fushat e studimit:

- Biologji;
- Biokimi;

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti Camerino, klikoni në adresën:

<http://d7.unicam.it/international/courses>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor 850 Euro në muaj për studentët;
- Kompensimin ditor 140 Euro për stafin akademik për mësimdhënie;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm) | Kompensimi |
|---|------------|
| Midis 100 dhe 499 KM | 180 EUR |
| Midis 500 dhe 1999 KM | 275 EUR |
| Midis 2000 dhe 2999 KM | 360 EUR |
| Midis 3000 dhe 3999 KM | 530 EUR |
| Midis 4000 dhe 7999 KM | 820 EUR |
| 8000 KM ose më shumë | 1100 EUR |

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor**:

-CV (në gjuhën angleze/italiane);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit;

-Listë notash (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit;

-Certifikatë e gjuhës së huaj B1 (Anglisht/Italisht në vartësi të programit të studimit);

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Camerino lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti** dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

-CV (në gjuhën angleze/italiane);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti;

-Diplomë e nivelit Bachelor;

-Listë notash e nivelit Bachelor (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);

-Listë notash e nivelit Master (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit;

-Certifikatë e gjuhës së huaj B1 (Anglisht/Italisht në vartësi të programit të studimit);

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillonit në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në*

tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Camerino lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti ** dhe në fund në Rektorat nga Koordinatorin Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze/italiane);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/italiane);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze/italiane (niveli B2);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

**Mobility Plan është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe në Rektorat nga Koordinatorin Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

Afati për aplikim: **20 Shkurt 2017**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt: “Aplikim për bursë në Universitetin Camerino, emrin dhe mbiemrin tuaj”.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!

**** Koordinatorët akademikë për firmosjen e Learning Agreement në nivel departamentesh.**

| Cikli i studimit | Programi i studimit | Autoriteti përgjegjës |
|---------------------------|---|------------------------------|
| <i>Bachelor</i> | <i>Biologji</i> | <i>Mirela Lika</i> |
| <i>Bachelor</i> | <i>Bioteknologji</i> | <i>Klementina Puto</i> |
| <i>Bachelor</i> | <i>Matematikë</i> | <i>Artur Baxhaku</i> |
| <i>Bachelor</i> | <i>Fizikë</i> | <i>Polikron Dhogina</i> |
| <i>Bachelor</i> | <i>Informatikë</i> | <i>Endri Xhina</i> |
| <i>Bachelor</i> | <i>Kimi</i> | <i>Kozeta Vaso</i> |
| <i>Bachelor</i> | <i>Kimi dhe Teknologji Ushqimore</i> | <i>Rozana Troja</i> |
| <i>Bachelor</i> | <i>Kimi Industriale dhe Mjedisore</i> | <i>Rozana Troja</i> |
| <i>Bachelor</i> | <i>Inxhinieri Matematike dhe Informatike</i> | <i>Fatmir Hoxha</i> |
| <i>Bachelor</i> | <i>Teknologji Informacioni dhe Komunikimi</i> | <i>Endri Xhina</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Biologji Mjedisore</i> | <i>Mirela Lika</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Biologji Molekulare</i> | <i>Mirela Lika</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Fizikë</i> | <i>Polikron Dhogina</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Biologji Molekulare dhe Industriale</i> | <i>Klementina Puto</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Kimi Industriale dhe Mjedisore</i> | <i>Rozana Troja</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Inxhinieria e Proceseve Kimike</i> | <i>Rozana Troja</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore</i> | <i>Rozana Troja</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Kimi</i> | <i>Kozeta Vaso</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Inxhinieri Matematike dhe Informatike</i> | <i>Fatmir Hoxha</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Informatikë</i> | <i>Endri Xhina</i> |

| | | |
|---------------------------|---|-------------------------|
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Matematikë</i> | <i>Artur Baxhaku</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Mësues në Kimi për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> | <i>Kozeta Vaso</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Mësues në Biologji për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> | <i>Mirela Lika</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Mësues në Fizikë për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> | <i>Polikron Dhoqina</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Mësues në Matematikë për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> | <i>Artur Baxhaku</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Mësues në Informatikë për Arsimin e Mesëm të Lartë</i> | <i>Endri Xhina</i> |
| <i>Master i Shkencave</i> | <i>Teknologji Informacioni dhe Komunikimi</i> | <i>Endri Xhina</i> |
| <i>Master Profesional</i> | <i>Bioteknologji Mjedisore</i> | <i>Klementina Puto</i> |
| <i>Master Profesional</i> | <i>Informatikë Biznesi</i> | <i>Endri Xhina</i> |
| <i>Master Profesional</i> | <i>Inxhinieri Matematike dhe Informatike</i> | <i>Fatmir Hoxha</i> |
| <i>Master Profesional</i> | <i>Menaxhimi i Teknologjive të Informacionit</i> | <i>Endri Xhina</i> |